



Almetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 22, datë 20.1.2021

PËR

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN
E HARTIMIT TË PROJEKTIT TË NDËRHYRJEVE
REHABILITUESE/PËRSHTATËSE TË NEVOJSHME
PËR KTHIMIN E STRUKTURËS SË OBJEKTEVE QË JANË
KLASIFIKUAR SI OBJEKTE ME DËMTIME TË MËDHA
STRUKTURE OSE DËMTIME SHUMË TË RËNDA
JOSTRUKTURE, NË BASHKITË KAMZË DHE KURBIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 10 637 537 (dhjetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore, në bashkitë Kamzë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:
 - a) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi, në masën 5 495 037 (pesë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tridhjetë e shtatë) lekë, për financimin e hartimit të projekteve të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, për ndërhyrjet strukturore të nevojshme, për njësitë individuale të banimit,

bazuar në rekomandimet e aktekspertizave të thelluara të bëra nga Instituti i Ndërtimit;

- b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 5 142 500 (pesë milionë e njëqind e dyzet e dy mijë e pesëqind) lekë, për financimin e hartimit të projekteve të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, për ndërhyrjet strukturale të nevojshme, për njësitë individuale të banimit, bazuar në rekomandimet e aktekspertizave të thelluara të bëra nga Instituti i Ndërtimit.
2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2021, dhe i transferohet, në formën e transfertës së pakushtëzuar, bashkive Kamzë dhe Kurbin.
3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kamzë dhe Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 266/1
DATE 21.1. 2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKIVE KAMZË DHE KURBIN
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAJI

